REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.142 Prot. Tiranë, më 24 /01/ 2020

V E N D I M

Nr.11 , Datë 24 /01/ 2020

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma "a", të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", mori në shqyrtim ankesën nr.136 regj, datë 24.10.2019, që i përket ankueses K. F, në të cilën ankuesja pretendon diskriminimin e djalit të saj D. F, për shkak të *"aftësisë së kufizuar", "gjendjes shëndetësore" dhe "gjendjes ekonomike"* nga ana e Zyrës Vendore Arsimore Korçë-Pustec dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi[1],

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesja shpjegon se, është nënë e tre fëmijëve, nga të cilët njërin e ka me probleme të thella të dëgjimit. Ai nuk dëgjon dhe nuk flet. Aktualisht djali është në klasën e parë në shkollën 9 vjeçare "Stavri Themeli", të qytetit të Korçës. Për shkak të problemit shëndetësor që fëmija ka, ai nuk mund të ecë si të gjithë shokët e tjerë në mësime. Ankuesja shprehet se ka bërë kërkesë pranë ZVA Korçë për vendosjen e mësuesit mbështetës, por akoma nuk ka marrë përgjigje.

Problemi që fëmija ka, e detyron ankuesen që ta shoqërojë në çdo moment kudo që shkon, pasi ka frikë që ta lë vetëm se pse nuk mund ta kuptojë asnjë. Ai është i ekspozuar totalisht nga aksidentet rrugore sepse nuk mund të dëgjojë. Ankuesja sqaron se i kanë thënë që ta çojë djalin në Tiranë për të vazhduar shkollën, por për shkak të gjëndjes ekonomike dhe faktit se ka edhe dy vajza të tjera të cilat janë në moshë të vogël dhe nuk mund t'i lërë vetëm, e ka te pamundur. Për këtë arsye ajo kërkon që të rekomandohen institucionet përkatëse për marrjen e kujdestarisë mbasi nuk ka ligj të mirëfilltë për të. Ankuesja shprehet se fëmija i saj dhe e gjithë kjo kategori duhet të trajtohen dhe të jenë të barabartë në përfitimin e shërbimeve publike dhe politikave gjithpërfshirëse.

[1]Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Përsa më sipër dhe bazuar në ligjin nr.10221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", ankuesja kërkon konstatimin e diskriminimit të djalit të saj D.F, dhe marrjen e masave për të ndrequr situatën diskriminuese nëpërmjet vendosjes së mësuesit ndihmës si dhe të rekomandohen institucionet përkatëse që të bëjnë ndryshime ligjore të kritereve për përfitimin e kujdestarisë KEMP.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma "a", të ligjit nr. 10221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*"[2], që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji Nr. 10 221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me shkaqet e pretenduara nga ankuesja (neni 1[3]). Ligji Për mbrojtjen nga diskriminimi, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në mënyrë të posaçme LMD parashikon mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e arsimit në Kreun III. LMD në nenin 17/1/c/ç[4], ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që bazohet në aftësinë e kufizuar, që i bëhet një nxënësi në gëzimin e të drejtës për arsim, duke përfshirë këtu si trajtimin dhe vlerësimin që i behet, por edhe përmbajtjen e parimeve dhe kritereve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies. LMD gjithashtu garanton mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve, e në mënyrë të posaçme ai parashikon në nenin 20/1 dhe 20/2/c, se, personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, veçanërisht në lidhje me mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun.

---

[2] Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD..

[3] Neni 1, të ligjit nr. 10221/2010*: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."*

[4] Neni 17/1//c/ç, të ligjit nr. 10221/2010: *"Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ..... c) përmbajtjen e parimeve dhe kritereve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies; ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre."*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenti 7 të LMD-së, garantohet *ndaj çdo veprimi apo mosveprim* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim.

Ankuesja K.F, legjitimohet të paraqese këtë ankesë duke pretenduar diskriminimin e djalit të saj, pasi ajo në ushtrim të përgjegjësisë prindërore për djalin e saj të mitur D. F, është edhe përfaqësuese e tij ligjore.Komisioneri mori në shqyrtim kërkimin e ankueses për sa i përket konstatimit të diskriminimit të djalit të saj në lidhje me mosofrimin e mësuesit ndihmës. Kërkimi tjetër i ankueses në lidhje me mospërfimtimin e kujdestarisë për fëmijën, nuk u mor në shqyrtim pasi Komisioneri është duke trajtuar situatën e personave që nuk dëgjojnë në kuadër të një çështje tjetër, të filluar kryesisht nga ana e tij. Meqënëse pretendimi për mospërfitimin e kujdestarisë nuk është pjesë e këtij shqyrtimi, atëherë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka legjitimitet pasiv për të qenë pjesë e kësaj procedure administrative.

Bazuar në nenin 33/7, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" Komisioneri çmoi të nevojshme marrjen e informacioneve lidhur me çështjet në shqyrtim edhe nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë, duke e bërë atë bazuar në nenin 33/3 të Kodit të Procedurave Administrive palë në këtë procedurë administrative dhe pse nuk është identifikuar si subjekt nga ana e ankueses.

Ankesa e paraqitur për pjesën e kërkimit të marrë në shqyrtim, është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe ajo u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën me nr. 1632/1 prot., datë 12.11.2019, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Shkolla 9-vjeçare "Stavri Themeli", Zyra Vendore Arsimore Korçë-Pustec dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë .
- Me shkresën nr. 239 prot, datë 21.11.2019, Zyra Vendore Arsimore Korçë-Pustec, ka dërguar parashtrimet e saj në lidhje me ankesën si dhe një pjesë të informacionit të kërkuar. Bashkëlidhur kësaj shkresë janë dërguar edhe shpjegimet e Shkollës 9-vjeçare "Stavri Themeli" në lidhje me këtë çështje.
- Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë dhe Zyrës Vendore Arsimore Korçë-Pustec, i'u kërkua plotësimi i informacionit.
- Me shkresën nr. 478 prot., datë 17.12.2019, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë, ka kthyer përgjigje në lidhje me plotësimin e informacionit.
- Me shkresën nr. 239/1 prot, datë 13.12.2019, Zyra Vendore Arsimore Korçë-Pustec ka kthyer përgjigje në lidhje me plotësimin e informacionit.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë proçesit të shqyrtimit të çështjes.

A.Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm

Bazuar në dokumentacionin e administruar rezulton se ankuesja K.F është e ëma e fëmijës D.F, i datëlindjes 23.01.2013, të cilët aktualisht jetojnë në Barç, Korçë. Sipas fletë drejtimit për KEMP, me nr. Regj A123740, datë 15.05.2019, lëshuar nga Shërbimi i Otorinolaringologjisë, i Spitalit Frances, në Qëndrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, rezulton se djali i ankueses vuan prej *Hypoacusi neurosensoriale profunde*. Sipas dokumentacionit mjekësor të administruar rezulton se bazuar në këtë diagnozë fëmija D. F ka ulje neuro-sensoriale të thellë të dëgjimit dhe për rrjedhojë ai nuk dëgjon dhe nuk flet. Fëmija rezulton gjithashtu se ka përfunduar frekuentimin e kopshtit (grupi i tretë).

Referuar procesverbalit datë 09.07.2019, të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë, rezulton se në mbledhjen e mbajtur në këtë ditë, Komisioni Multidisiplinar që funksionon pranë DRAP Korçë, ka vlerësuar nevojat për arsim të fëmijës D. F. Ky komision ka vlerësuar se fëmija mund të ndjekë shkollën e zakonshme dhe se për të siguruar në mënyrë efektive të drejtën për arsim fëmija ka nevojë për mësuese ndihmëse përgjatë 2-dy orëve mësimore çdo ditë. Më datën 13.09.2019, ankuesja i është drejtuar me një kërkesë DAR Koçë, duke kërkuar që bazuar në ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe Dispozitat Normative, të miratuara me urdhrin nr. 343, datë 19.08.2013, të Ministrit të Arsimit, djalit të saj t'i mundësohej mbështetja me mësues ndihmës, sipas rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar.

Rezulton se fëmija D.F, është regjistruar në klasën e parë të shkollës 9-vjeçare Stavri Themeli dhe ka filluar vitin shkollor 2019-2020, pa i'u siguruar një mësues ndihmës, sipas rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit të Fëmijëve, pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë (DRAP Korçë). Sipas informacionit të dërguar nga ZVA Korçë-Pustec, rezulton se Komisioni i Vlerësimit të nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollën 9 vjeçare Stavri Themeli është mbledhur dhe ka vlerësuar nevojat e fëmijës D. F në muajin tetor 2019. Bazuar në vlerësimin e fëmijës është hartuar Plani i Edukimit Individual (PEI), i cili mban datën 15.10.2019. Po në datën 15.10.2019, sipas shkresën me nr. 9 prot, rezulton se Shkolla 9-vjeçare Stavri Themeli i është drejtuar ZVA Korçë –Pustec me një kërkesë për mësues ndihmës për të mbështetur nevojat e fëmijës, sipas rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar. Në përgjigje të kësaj kërkesë të bërë nga ana e shkollës, me shkresën nr. 197 prot, datë 15.10.2019, ZVA Korçë-Pustec, ka bërë një deklaratë për mungesë në portal të mësues ndihmës. Këtë deklaratë ia ka përcjellë shkollës, duke e informuar se në listën e fituesve të portalit "Mësues për Shqipërinë" nuk ka asnjë fitues për këtë profil dhe i ka rekomanduar shkollës që në bazë të Dispozitave Normative, fëmija të asistohet nga prindi deri në krijimin e hapësirave ligjore për emërimin e mësuesit ndihmës. Ankuesja ka pretenduar përpara Komisionerit se djali i saj është trajtuar në mënyrë të padrejtë duke i'u refuzur mbështetja me mësues ndihmës. Për të vlerësuar në lidhje me trajtimin e padrejtë të djalit të

ankueses i referohemi legjislacionit të posaçëm që rregullon arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

E drejta për arsimim është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Bazuar në Kushtetutë, kushdo ka të drejtën për arsimim. Ligji Nr. 69/2012 "*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",* i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsim, në nenet 63-65, rregullon shprehimisht arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në nenin 63, pika 3, ligji nr. 69/2012, garantohet e drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, për nxënësit që nuk dëgjojnë. Ligji garanton ne nenin 64/3 dhe 65/3, të drejtën e nxënësve me aftësi të kufizuara për të patur mësues ndihmës, bazuar në rekomandimin e komisionit multidisiplinar që bën vlerësimin e nevojave të fëmijëve. Dispozitat Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar[5], në nenet 93-101, parashikojnë rregulla të detajuara në lidhje me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu fëmijët që nuk dëgjojnë, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë për çdo institucion.

Bazuar në nenin 93, të Dispozitave Normative, parashikohet se Komisioni Multidisiplinar i ngritur pranë institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar i cili realizon vlerësimin e nevojave të fëmijës me aftësi të kufizuara, ndër të tjera, jep rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjelltas ; sugjeron kopshtin/shkollën me kushtet më të përshtatshme për nxënësin si dhe rekomandon shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese.

Fëmija D.F është vlerësuar nga Komisioni Multidisiplinar i ngritur pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë me datë 09.07.2019, i cili ka vlerësuar nevojat e tij duke rekomanduar shkollën Stavri Themeli që: fëmija të ndjekë arsimin e zakonshëm duke u regjistruar në klasën e parë pranë kësaj shkolle; mbështetjen e nxënësit nga një mesues ndihmës përgjatë 2 orëve mësimore çdo ditë dhe të ndjekë nxënësin bazuar në Planin Edukativ Individual.

Bazuar në nenin 95 të Dispozitave Normative, drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm ngre komisionin për nxënësit me aftësi të kufizuara, i cili bazuar në vlerësimin e komisionit pranë institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar : a) udhëzon mësuesit për hartimin e PEI-ve dhe i miraton; b) ndihmon mësuesit gjatë zbatimit të PEI-ve; c) ndjek ecurinë e fëmijëve me AK.

Sipas dokumentacionit dhe informacionit të administruar, rezulton se shkolla 9-vjeçare "Stavri Themeli", Korçë ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të nxënësve me aftësi të kufizuara, i cili ka vlerësuar fëmijën D.F në tetor 2019, sipas procesverbalit të mbajtur më datën 15.10.2019. Gjithashtu rezulton se në bashkëpunim me prindin e fëmijës është hartur Plani Edukativ Individual. Rezulton se në bazë të shkresës nr. 9 prot datë 15.10.2019, shkolla 9 –vjeçare Stavri

[5] Miratuar me urdhrin nr. 343, datë 19.08.2013, të Ministrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, ndryshuar me urdhrin nr. 37, datë 29.01.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Themeli i është drejtuar Zyrës Vendore Arsimore Korçë Pustec me një kërkesë për mësues ndihmës, bazuar në rekomandimin e Komisionit Multidisiplinar të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë. Me shkresën e datës 13.09.2019, rezulton se dhe ankuesja i është drejtuar DAR Korçë me një kërkesë për t'i siguruar fëmijës një mësues ndihmës e fëmijës me një mësues ndihmës sipas rekomandimit të bërë nga Komisioni Multidisiplinar i ngritur pranë DAR Korçë, për të cilën ankuesja shprehet se nuk ka marrë përgjigje. Në përgjigje të kërkesës së shkollës për mësues ndihmës, Zyra Vendore Arsimore Korçë Pustec, ka informuar shkollën se në bazë të udhëzimit ne 13 datë 22.05.2019 tek lista e fituesve të portalit "Mësues për Shqipërinë" nuk ka asnjë fitues për profilin e kërkuar dhe ka rekomanduar që bazuar në përcaktimet e Dispozitave Normative të asistohet nga prindi deri në krijimin e hapësirave ligjore për emërimin e mësuesit ndihmës.

Procedurat dhe kritere më të detajuara për sigurimin e mësuesit ndihmës përcaktohen në nenin 97, të Dispozitave Normative, udhëzimin nr. 38, datë 07.10.2014, "*Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar*" si dhe në udhëzimin nr. 13, datë 22.05.2019, *"Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë"*, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Në nenin 97 të Dispozitave Normative, përcaktohet se, sipas normës së përcaktuar nga ministri dhe vlerësimit nga komisioni pranë DAR/ZA-së, në klasat e zakonshme që kanë edhe fëmijë me aftësi të kufizuar punojnë mësues ndihmës duke përcaktuar më tej edhe kriteret që duhet të plotësojë si dhe detyrat e mësuesit ndihmës.

Udhëzimi nr. 38, datë 07.10.2014[6], i cili ka dalë në bazë të nenit 65/3 të ligjit nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*" dhe nenit 97, Kreu XV të "*Dispozitave Normative të Sistemit Arsimor Parauniversitar*", në pikën 5, kreu I, përcaktohen se, është Komisioni Vlerësues i ngritur pranë Njësive Arsimore Vendore (DAR/ZA-ve, sot DRAP/ZVA), i cili përcakton nevojën e nxënësit me aftësi të kufizuara për mësues ndihmës në klasë ose në shtëpi, si dhe numrin e orëve mësimore të nevojshme për çdo nxënës me aftësi të kufizuara. Sipas pikës 2, të Kreut I, të këtij udhëzimi përcaktohet se procedurat e përzgjedhjes së mësuesve ndihmës dhe largimit nga puna janë në përputhje me udhëzimin nr. 35, datë 30.09.2014 "*Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar*"[7], i cili nuk është më në fuqi dhe aktualisht është zëvendësuar nga udhëzimi nr. 13, datë 22.05.2019 "*Për procedurat e pranimit të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë",* i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sipas pikës 8, të Kreut 8, të udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019, përcaktohet se mësuesit ndihmës do të

[6] Ky udhëzim ka qenë në fuqi në momenin e kohën kur ka ndodhur ngjarja. Ky udhëzim është shfuqizuar me udhëzimin nr. 26, datë 25.11.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

[7] Udhëzimi nr. 35 datë 30.09.2014, është shfuqizuar nga udhëzimi nr. 38, datë 06.10.2015 dhe ky i fundit është shfuqizuar nga udhëzimi i cili aktualisht është në fuqi nr. 13, datë 22.05.2019, i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

punësohen nga kandidatët e portalit "Mësues për Shqipërinë", të profilit "Arsim special", sipas procedurave të këtij udhëzimi. Referuar pikës 4, të Kreut 5, të udhëzimit, përcaktohet se: *"Në mungesë të kandidatëve të profilit "Arsim special", për plotësimin e vendeve të lira për mësues ndihmës, ZVAP vendos si më poshtë: a) Nëse nga institucionet arsimore do të kërkohen mësues ndihmës në arsimin fillor, ZVAP do të njoftojë për punësim kandidatët nga portali "Mësues për Shqipërinë" në profilin "Arsim Fillor" sipas renditjes."*

Në shkresën nr. 239 prot datë 21.11.2019, ZVA Korçë-Pustec, sqaron se : *"....në lidhje me emërimin e mësuesit ndihmës pikësëpari problemi qëndron që tek udhëzimi nr. 38 datë 07.10.2014 "Për kriteret e mësuesit ndihmës" sepse parashikohet që numri i mësuesve ndihmës duhet të jetë brenda numrit të përgjithshëm të mësuesve të miratuar për çdo DAR/ZA (tashmë ZVA) dhe ZVA Korçë Pustec nuk ka hapësirë ligjore për të punësuar një mësues ndihmës për këtë fëmijë, duke theksuar se nga ana e e tyre është bërë kërkesë për shtimin e numrit të punonjësve në mënyrë që të mbulohen nevojat e fëmijës. Problemi tjetër është se emërimet e mësuesve bëhen sipas udhëzimit nr. 13 datë 22.05.2019 të MASR, ku shprehet se mësuesi ndihmës duhet të jetë i renditur në portal në profilin "Arsim Special". ZVA Korçë Postec nuk ka asnjë kandidat të renditur në këtë profil. Në mungesë kandidati udhëzimi sqaron se duhet marrë profili më i afërt në varësi të moshës së fëmijës, konkretisht nga profili fillor. Duke marrë nevojat që ka ky fëmijë, caktimi i një mësuesi ndihmës që nuk njeh gjuhën e shenjave nuk do të ndikonte për mirë në zhvillimin e fëmijës. Në përfundim edhe pse për shkaqe objektive nuk mund ti sigurojmë mësues ndihmës, kjo nuk përbën shkak për diskriminim"*

Me shkresën nr. 239/1 prot, datë 13.12.2019, ZVA Korçë Pustec sqaron se : *"Numri total i punonjësve në arsim për ZVA Korçë është 747 nga të cilët 14 janë mësues ndihmës dhe ka të punësuar 14 mësues ndihmës nga 14 të mundshëm. Punësimi mbi këtë numër do të shkaktonte pamundësinë e mbulimit me pagë të këtij mësuesi. Është raportuar pranë DRAP Korçë për këtë mungesë dhe është kërkuar shtim numri në këtë drejtim. Në momentin e miratimit të numrit, nëse një gjë e tillë do të ndodh, do të lajmërohen të gjithë kandidatët e profilit arsim fillor që do të njohin gjuhën e shenjave, për shkak të specifikave që paraqet ky fëmijë...."*

Me shkresën nr. 478 prot, datë 17.12.2019, DRAP Korçë informon se: *" ZVA Korçë-Pustec, sipas statistikave të mbledhura ka 50 nxënës me aftësi ndryshe në ciklin fillor, 34 në ciklin e lartë. Sipas mundësive për plotësim me personel mësimor, duhet të caktohet një mësues për çdo katër nxënës me aftësi ndryshe. Aktualisht ZVA Korçë Pustec ka 14 mësues ndihmës nga 14 të mundshëm dhe është kërkuar nëpërmjet institucionit tonë shtesë në personel; mësues ndihmës me qëllim mbulimin e të gjithë nxënësve me aftësi të kufizuara..... Me mundësinë e parë që do të krijohet do të caktohet një mësues ndihmës....."*

Ligji "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", garanton të drejtën për mësues ndihmës të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët janë vlerësuar nga Komisioni Multidisiplinar se kanë nevojë për mbështetje nëpërmjet një mësuesi ndihmës, në mënyrë që të realizohet në mënyrë efektive e drejta e tyre për arsim. Mbështetja nëpërmjet një mësuesi ndihmës

është një ndër format, por jo forma e vetme e mbështetjes që duhet të ofrohet në mënyrë që të garantohet pa diskriminim e drejta për arsim e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Neni 65 i ligjit "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", parashikon se nxënësit me aftësi të kufizuara duhet të mësojnë sipas një plani mësimor që në çdo rast duhet të jetë i përshtatur me nevojat e fëmijës, duke vendosur kështu detyrimin për hartimin e planeve mësimore-edukative të personalizuara për çdo nxënës me aftësi të kufizuara.

Fëmija i ankueses, pra nxënësi D.F është vlerësuar nga Komisioni Multidisiplinar se për të realizuar në mënyrë cilësore arsimimin e tij e për rrjedhojë edhe zbatimin efektiv të Planit Edukativ Individual (PEI) që është përgatitur për të, është e nevojshme mbështetja me anë të një mësuesi ndihmës. Pra, përgatitja e PEI dhe sigurimi i mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara janë detyrime të ndërlidhura por nuk janë e njëjta gjë, janë dy detyrime të ndryshme nga njëra tjetra dhe të detyrueshme për autoritetet përgjegjëse për të garantuar të drejtën për arsim të individëve. Detyrimi për të siguruar mësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara nëpërmjet hartimit, zbatimit dhe monitorimit të PEI dhe detyrimi për të siguruar mbështetjen me mësues ndihmës, kur është vlerësuar nga Komisioni Multidisiplinar, janë dy detyrime që dalin qartë nga neni 65, pikat 1,2 dhe 3, të Ligjit "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*"[8] dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Sipas udhëzimit të ri të MASR nr. 26, datë 25.11.2019 "*Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar"*, i cili ka shfuqizuar udhëzimin e mëparshëm të MASR nr. 38 datë 07.10.2014, i cili rregullonte procedurat dhe kriteret për mësuesin ndihmës, mësuesi ndihmës duhet të jetë i profilit "arsim special" dhe në mungesë të këtij profili mësuesi të jetë i pajisur me diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit, në përputhje me nenin 57/2 të ligjit nr. 69/2012 si dhe të ketë kryer trajnime për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Procedurat e rekrutimit të mësuesit ndihmës do të vazhdojnë të kryhen në përputhje me udhëzimin për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "*Mësues për Shqipërinë*". Udhëzimi ka përcaktuar se Komisioni Multidisiplinar i ngritur pranë ZVAP-ve do të jetë ai që do përcaktojë nevojën arsimore të nxënësit si dhe nevojën për mësues ndihmës dhe numrin e orëve mësimore të nevojshme. As udhëzimi i mëprashëm pra udhëzimi nr. 38, datë 07.10.2014 dhe as udhëzimi i ri nr. 26 datë 25.11.2019, nuk i japin kompetencë ZVAP-ve apo DRAP-ve të vlerësojë nevojën arsimore të nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nevojën për

[8] Neni 65, pika 1, 2, 3 të ligjit "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*": *"1. Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta. 2. Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënit të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës. 3. Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve."*

mbështetje me mësues ndihmës. Nëse Komisioni Multidisiplinar ka vendosur që mësimi i fëmijës dhe zbatimi i PEI duhet të realizohet duke siguruar mbështetjen me mësues ndihmës, atëherë autoritetet përgjegjëse për të siguruar arsimin parauniversitar në nivel vendor duhet të marrin masa për zbatimin e tij. Nëse arsimi i fëmijës nuk realizohet në përputhje me vlerësimet e Komisionit Multidisiplinar, kjo do të thotë se arsimimi i tij nuk po realizohet në mënyrë cilësore dhe në baza të barabartë me të tjerët, pasi i është mohuar mbështetja e duhur për të arritur cilësinë në arsim. Me udhëzimin e ri nr. 26, datë 25.11.2019 nuk është më në fuqi parashikimi që bënte udhëzimi i mëparshëm nr. 38 datë 07.10.2014, sipas të cilit numri i mësuesve ndihmës duhet të ishte brenda numrit të përgjithshëm të mësuesve të miratuar për ZVAP.

Sa më sipër rezulton se fëmijës së ankueses, nxënësit D. F, i cili është një fëmijë me aftësi të kufizuara i është mohuar e drejta për të patur mbështetje nëpërmjet një mësuesi ndihmës sipas vlerësimit të bërë nga Komisioni Multidisiplinar, në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi si më sipër janë përmendur. Mungesa e mësuesit ndihmës e vendos fëmijën D. F, në kushte më pak të favorshme për të siguruar me të njëjtën cilësi dhe mbi baza të barabarta me fëmijët e tjerë të drejtën për t'u arsimuar, duke e ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, referuar parashikimit të bërë në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*".

B. Shkaku i mbrojtur

Neni 1, i ligjit nr. 10221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*"[9], i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Ky nen parashikon një sërë shkaqesh, por ndërkohë përcakton se lista e shkaqeve të mbrojtura mbetet e hapur. Ligji ka përcaktuar në nenin 2, të tij se përpos qëllimit për të garantuar barazinë përpara ligjit , ka si qëllim të garantojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi.

Ligji parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. E në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të pabarabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.[10]

Duke mbajtur në konsideratë nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3 por edhe në referim të nenit 6, të ligjit, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura dhe për të cilat nuk ekziston një arsye objektive dhe e arsyeshme.

[9] Shih më lart *footnote* nr. 3.
[10] Raporti shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

Ankuesja ka pretenduar se trajtimi diskriminues i djalit të saj bazohet në më shumë se një shkak, duke pretenduar si shkaqe diskriminimi "gjendjen shëndetësore", "aftësinë e kufizuar" dhe "gjendjen ekonomike". Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010, të tre këto shkaqe konsiderohen shkaqe të mbrojtura.

Bazuar në dokumentacionin e administruar, rezulton i provuar shkaku i gjëndjes shëndetësore, pasi në bazë të dokumentacionit të administruar rezulton se fëmija D.F, vuan prej *Hypoacusia neurosensoriale profunde,* diagnozë klinike kjo e përcaktuar në bazë të raporteve mjekësorese.

Bazuar në diagnozën mjekësore me të cilën është diagnostituar fëmija i ankueses, Komisioni Multidisiplinar i Vlerësimit të Nevojave për Arsim e ka konsideruar atë si një fëmijë me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se ankuesja ka të vërtetuar shkakun e aftësisë së kufizuar. Meqënëse gjendja shëndetësore e djalit të ankueses është konsideruar si aftësi e kufizuar, atëherë Komisioneri gjykon se ajo përfshihet brenda aftësisë së kufizuar dhe nuk e gjen të nevojshme që ta trajtoj si shkak më vetë.

Në lidhje me shkakun tjetër të pretenduar, atë të gjendjes ekonomike, ankuesja nuk ka depozituar ndonjë dokumentacion që të tregojë për gjëndjes e saj ekonomike. Megjithatë duke ju referuar shpjegimeve të dhëna në ankesë, gjendja ekonomike nuk referohet prej ankueses si shkak ku bazohet trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i pretenduar prej saj, por më tepër si një pasojë që vjen nga gjëndja dhe aftësia e kufizuar e fëmijës së saj. Personat me aftësi të kufizuar por edhe familjarët e tyre kanë më tepër gjasa që të jetojnë në kushte më të vështira ekonomike duke krijuar një lidhje të ndërsjelltë shkak pasojë midis aftësisë së kufizuar dhe gjëndjes jo të mirë ekonomike. Nga analiza e fakteve dhe pretendimeve të ankueses, edhe pse kjo e fundit e ka pretenduar gjendjen ekonomike si shkak diskriminues, nuk rezulton të ketë një lidhje midis saj dhe mos sigurimit të mësuesit ndihmës.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur

Duke risjelle në vëmendje faktin se jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i padrejtë përbën diskriminim e për rrjedhojë gëzon mbrojtje nga ligji "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", por vetëm ai trajtim i padrejtë dhe më pak i favorshëm që ka si bazë një shkak të mbrojtur nga legjislacioni dhe për të cilin nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, Komisioneri vlerëson se :

Rezultoi e provuar se fëmijës së mitur të ankueses D.F, i cili ndjek arsimin fillor në klasën e parë në institucionin arsimor publik shkollën 9 vjeçare "Stavri Themeli", në qytetin e Korçë, nuk i është siguruar mbështetja për ndjekur procesin mësimor me mësues ndihmës, sipas vlerësimit të nevojave që i është bërë këtij fëmije nga ana e Komisionit Multidisiplinar, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Në këtë mënyrë, Komisioneri si më sipër është arsyetuar konstatoi se fëmija D. F, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e më pak të favorshëm duke cënuar të drejtën e tij për arsim.

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e parashikuar në nenin 57 të kushtetutës, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim. Rëndësia e të drejtës për edukim mbështetet në atë që, ushtrimi i shumë të drejtave të tjera, varet në radhë të parë nga realizimi i të drejtës për arsim, siç theksohet në Komentin e Përgjithshëm Nr.13 (1999), të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, mbi të drejtën për arsim. E drejta për arsim garantohet në kuadër të shumë marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor jo vetëm të detyrueshme për t'u zbatuar por bazuar në nenin 116 të Kushtetutës në hierarkinë e normave juridike ato renditen menjëherë pas Kushtetutës, të tilla si: Konventa e UNESCO Kundër Diskriminimit në Arsim; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Social dhe Kulturore, garanton të drejtës për arsim në nenet 13 e 14; Protokolli shtesë i Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, në nenin 2, sanksionon se askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsim dhe Konventa e OKB-së "Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara" (KDPAK).

KDPAK përbën standartin më të lartë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Kjo Konventë në nenin 24 të saj, njeh të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim. Sipas nenit 24, të KDPAK, e drejta për arsim e personave me aftësi të kufizuara realizohet pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, nëse garantohet një sistem edukimi gjithëpërfshirës. Sipas pikës 2, të nenit 24 të KDPAK, për të realizuar këtë të drejtë, shteti duhet të sigurojë se:

- personat me aftësi të kufizuara nuk janë përjashtuar nga sistemi i edukimit të përgjithshëm për shkak të aftësisë së kufizuar, dhe se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë përjashtuar nga arsimi pa pagesë dhe i detyruar fillor, ose arsimi i mesëm, me bazë aftësinë e kufizuar;
- personat me aftësi të kufizuara mund të kenë mundësinë për edukimin fillor përfshirës, cilësor dhe pa pagesë dhe arsimin tetëvjeçar në baza të barabarta me të tjerët në komunitetet ku ata jetojnë;
- sigurohet akomodimi i arsyeshëm i kërkesave individuale;
- personat me aftësi të kufizuara marrin mbështetjen e kërkuar brenda sistemit të edukimit të përgjithshëm, për të mundësuar arsimimin e tyre efektiv;
- sigurohen masa mbështetëse efektive të individualizuara në ambiente që rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror, në pajtim me qëllimin për përfshirje të plotë.

Bazuar në pikën 3, të nenit 24, të KDPAK, parashikohet se, shteti duhet të mundësojnë personat me aftësi të kufizuara të mësojnë mjeshtëri për zhvillim shoqëror dhe jetësor për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në edukim dhe si anëtarë të komunitetit. Për këtë qëllim masat e duhura që duhen marrë përfshijne ndër të tjera lehtësimin e të mësuarit të gjuhës së shenjave dhe promovimin e identitetit linguistik të komunitetit të personave që nuk dëgjojnë si dhe sigurimin e faktit se edukimi i personave, dhe në veçanti i fëmijëve të cilët janë të verbër, që nuk dëgjojnë apo që nuk dëgjojnë e nuk shikojnë, në të njëjtën kohë u është dhënë në gjuhën, mënyrat dhe mjetet e komunikimit më të përshtatshme për individin dhe në ambiente të cilat rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror.

Fëmija si çdo qënie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionon të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta.(neni 28 i Konventës) Ligji i posaçëm që mbron të drejtat e fëmijës, konkretisht ligji nr. 18/2017 "*Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës*", sanksionon se realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke u bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim.

Legjislacioni në fuqi në përputhje me standartet ndërkombëtare parashikon që e drejta për arsim garantohet pa diskriminim për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga aftësia e kufizuar. Por garantimi i të drejtës për arsim nuk nënkupton vetëm pranimin në shkollë dhe prezencën fizike të fëmijëve në klasa, por që fëmijët të marrin një arsim gjithëpërfshirës cilësor dhe të barabartë. Përfshirja nuk duhet ngatërruar me integrimin. Integrimi është procesi i vendosjes së personave me aftësi të kufizuara në institucionet ekzistuese arsimore me arsyetimin që ata mund të përshtaten me kërkesat e standardizuara të institucioneve të tilla. Gjithëpërfshirja kërkon një proces reformash që mishërojnë ndryshime dhe modifikime në përmbajtje, metodat e mësimdhënies, qasjet, strukturat dhe strategjitë në arsim për të kapërcyer pengesat me një vizion që shërben për t'u ofruar të gjithë studentëve sipas moshave një përvojë të drejtë dhe pjesëmarrëse të të mësuarit dhe mjedisin që korrespondon më së miri me kërkesat dhe preferencat e tyre. Vendosja e studentëve me aftësi të kufizuara brenda klasave të zakonshme, pa u shoqëruar ndryshime strukturore, për shembull, në organizim, kurrikul dhe strategji mësimore dhe të nxënit, nuk përbën përfshirje. Për më tepër, integrimi nuk garanton automatikisht kalimin nga segregimi në përfshirje. Segregimi ndodh kur edukimi i nxënësve me aftësi të kufizuara realizohet në ambiente të ndara të krijuara apo që përdoren për t'iu përgjigjur një dëmtimi të caktuar apo dëmitimeve të ndryshme, të ndarë nga nxënësit pa aftësi të kufizuara. Gjithëpërfshirja nuk përbëhet dhe nuk konsiderohet e përmbushur vetëm nga një element si psh hartimi PEI. Gjithëpërfshirja kërkon ndërmarrjen e një tërësi veprimesh në mënyrë që të realizohet duke përfshirë këtu edhe ofrimin e mbështetjes me mësues ndihmës, një e drejtë kjo që garantohet nga legjislacioni në fuqi.

Sipas Komentit të Përgjithshëm Nr.13 (1999), të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, *mbi të drejtën për arsim*, arsimi në të gjitha format e tij dhe në të gjitha nivelet duhet të ketë karakteristikat si vijon, të cilat janë thelbësore dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën: disponueshmëria, mundësia e përdorimit/ aksesueshmëria, pranueshmëria, përshtatshmëria. Sipas Komentit të përgjithshëm nr. 4 (2016) për të drejtën për arsim gjithëpërfshirës, të Komitetit të OKB-së Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, për të vlerësuar garantimin e të drejtës për arsim gjithëpërfshirës, duhet të merren në konsideratë të katërt këta elementë apo karakteristika. Nën karakteristikën e përshtatshmërisë që duhet të ketë arsimi gjithpërfshirës, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 4, paragrafet 27 dhe 32, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara sqaron se:

Në përputhje me nenin 24 (2) (b) të Konventës, personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë në gjendje të ndjekin shkollat fillore dhe të mesme në komunitetet ku ata jetojnë. Nxënësit nuk duhet të dërgohen larg shtëpisë.

Që neni 24 (2) (e) të realizohet, duhet të ofrohet menjëherë mbështetje e përshtatshme, e vazhdueshme dhe e personalizuar. Komiteti thekson nevojën për të siguruar plane arsimore të individualizuara që mund të identifikojnë përshtatje të arsyeshme dhe mbështetje specifike të kërkuar nga nxënës të veçantë..... Mbështetja gjithashtu mund të përbëhet nga një asistent i kualifikuar i cili ndihmon në mësim, qoftë mbi baza të përbashkëta ose në baza një-për-një, në varësi të kërkesave të nxënësit..... Efektiviteti i planeve të tilla duhet të monitorohet dhe vlerësohet rregullisht me përfshirjen e drejtpërdrejtë të nxënësit. Natyra e këtyre masave duhet të përcaktohet në bashkëpunim me nxënësin, së bashku, kur është e përshtatshme, me prindërit, kujdestarët ose palët e tjera të treta.

Ashtu siç shprehet edhe ankuesja, për shkak se fëmijës së saj nuk i sigurohet një arsim gjithëpërfshirës cilësor, ajo ka menduar që edhe mund ta largojë fëmijën e saj larg shtëpisë për të ndjekur arsimin, por kjo nuk është ajo që ankuesja si prind dëshiron për fëmijën e saj që ta ketë larg. Dërgimi larg shtëpisë i nxënësve me aftësi të kufizuara nuk nënkupton vetëm largimin e detyruar të tyre, por përfshin edhe situatën kur pa vullnetin e tyre dhe për shkak se nuk u sigurohet një arsim gjithëpërfshirës cilësor ato ndihen të detyruar të largojnë fëmijët e tyre kundër dëshirës së tyre.

Legjislacioni në fuqi në përputhje me parashikimet e KDPAK, garanton të drejtën e nxënësve me aftësi të kufizuara për arsim gjithëpërfshirës duke parashikuar se ata kanë të drejtën për mbështetje nëpërmjet mësuesit ndihmës. Shpjegimet e ZVA Korçë-Pustec dhe DRAP Korçë se mësuesi ndihmës nuk është siguruar për mungesë personeli mësimor, pra për arsye financiare por sipas tyre edhe në mungesë të mësuesit ndihmës është respektuar legjislacioni në fuqi dhe është siguruar arsimimi i fëmijës, pasi është hartuar PEI i cili ndiqet me përpikmëri nga mësuesi lëndor, se shërbimi psikosocial e ka në trajtim, që i është dhënë mundësia prindit që ta ndjekë fëmijën në klasë në mënyrë që ta lehtësojë në kuptimin e mësimit nuk përbëjnë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Shërbimi psikosocial është një shërbim që ofrohet për të gjithë fëmijët sipas dispozitave ligjore në fuqi, pra ofrohet edhe për fëmijët pa aftësi të kufizuara. Hartimi i PEI zbatimi dhe monitorimi i tij është një detyrim ligjor i ndryshëm nga mësuesi ndihmës i cili në rast se nuk sigurohet mbështetja me mësues ndihmës zbatimi i tij në mënyrë efektive dhe cilësore cënohet. Kjo do të thotë se nëse Komisioni Multidisiplinar ka vlerësuar nevojën që fëmija të ketë një mësues ndihmës i cili do të sigurojë zbatimin efektiv dhe cilësor të PEI, pretendimi se PEI zbatohet dhe monitorohet me përpikmëri gjithashtu është i pabazuar. Për sa i përket shpjegimeve të bëra nga palët se prindit i është dhënë mundësia që të asistojë fëmijën në klasë, gjithashtu është në keqzbatim të legjislacionit. Ligji "*Për Arsimin Parauniversitar*" sanksionon në nenin detyrimin për të bashkëpunuar me prindërit në hartimin ose ndryshimin e PEI. Detyrimi i institucionit arsimor dhe

stafit mësimor për të bashkëpunuar me prindërit përcaktohet edhe në Kreun XV të dispozitave normative e në veçanti në nenin 97. Mundësia që i është dhënë ankueses për të asistuar fëmijën e saj në klasë nuk është një favor që i është bërë ankueses, por tregon për dështimin për të përmbushur detyrimin ligjor për të siguruar mësues ndihmës. Kjo është në fakt një dështmi e nevojës që fëmija ka për mbështetje me mësues ndihmës në mënyrë që të marrë një arsim cilësor si gjithë fëmijët e tjerë. Detyrimi për të siguruar mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara nuk duhet të kalojë mbi familjen pasi është një detyrim ligjor i institucioneve përgjegjëse pa mohuar këtu detyrimin për të bashkëpunuar me prindërit apo familjen e fëmijës.

Justifikimi i ofruar nga ZVA Korçë-Pustec në lidhje me mos ofrimin e mësuesit ndihmës është kontradiktor. Në përgjigjen që ky institucion i ka kthyer shollës 9-vjeçare Stavri Themeli, shprehet se është e pamundur sigurimi i mësuesit ndihmës pasi ka mungesë në portalin "Mësues për Shqipërinë" të profilit të kërkuar. Ndërkohë në informacionin që ky institucion ka përcjellë pranë Komisionerit rezulton se edhe nëse në portal do të kishte mësues sipas profilit të kërkuar, rezulton se përsëri do të ishte e pamundur sigurimi i mësuesit ndihmës pasi ZVA Korçë-Pustec nuk ka hapësirë ligjore për të punësuar një mësues ndihmës, pasi ka të punësuar 747 mësues nga 747 mësues që ka të miratuar. Në lidhje me faktin se ZVA Korçë-Pustec shprehet se, mësuesi ndihmës do të caktohet në rast se do të njohë gjuhën e shënjave, Komisioneri vlerëson se njohja e gjuhës së shenjave nga mësuesi ndihmës do të përbënte ndihmën më të mirë për fëmijën, por duke vlerësuar nevojën për mbështetje të menjëhershme dhe faktin se është në interesin më të lartë të fëmijës që të marrë mbështetje nga një mësues profesionist dhe jo të asistohet nga prindëri gjatë orëve të mësimit, edhe pse ky mësues ndihmës nuk e njeh gjuhën e shenjave, ky arsyetim i ZVA Korçë-Pustec është i pabazuar.

Nxënësve që nuk dëgjojnë në bazë të ligjit u garantohet e drejta për arsim në gjuhën e shenjave. Gjithashtu mos sigurimi i kësaj të drejtë i diskriminon këta fëmijë. Garantimi i të drejtës për arsim siç është theksuar edhe më sipër përfshin një sërë karakteristikash dhe elementësh e padyshim edhe mundësimin për t'u arsimuar në gjuhën e shenjave të personave që nuk dëgjojnë. Nga tërësia e dokumentacionit dhe informacionit të administruar rezulton se një e drejtë e tillë nuk është garantuar për fëmijën e ankueses, fakt ky që e rëndon akoma më shumë situatën dhe cilësinë e arsimit që sigurohet për këtë fëmijë. Një gjë e tillë e vendos fëmijën e ankueses në pozita diskriminuesë në raport me fëmijët e tjerë që kanë mundësinë të arsimohen në gjuhën e tyre, ndërsa atij nuk i ofrohet mundësia për t'u arsimuar në gjuhën e shenjave shqipe. Kjo nuk ndikon në konstatimin e bërë më sipër se mësuesi ndihmës duhet të ofrohet në mënyrë të menjëhershme edhe në mungesë të njohjes së gjuhës shqipe të shenjave, duke u angazhuar njëkohësisht që në momentin më të parë të mundshëm fëmijës t'i sigurohet arsimi në gjuhën shqipe të shenjave. Për më tepër që garantimi i të drejtës për tu arsimuar në gjuhën e shenjave shqipe për personat që nuk dëgjojnë nuk plotësohet vetëm duke mundësuar që mësuesi ndihmës të njohë gjuhën e shenjave shqipe, por kërkon edhe tekste dhe mjete të tjera shkollore të përshtatshme në gjuhën e shënjave shqipe.

Djali i ankueses është në klasën e parë fillore dhe nevoja për mbështetje është e një rëndësie të veçantë në mënyrë që fëmijës t'i eleminohen pengesat që në momentet fillestare të arsimimit të tij, me qëllimin për t'i siguruar një arsim cilësor dhe mbi baza të barabarta. Fëmija sapo ka filluar shkollën dhe ai nuk ka njohuri për gjuhën e shenjave shqipe. Gjuhën e shenjave shqipe ai duhet t'a mësojë në shkollë.

Gjuha e shenjave shqipe është zyrtarizuar me VKM nr. 837, datë 3.12.2014 *"Për njohjen e gjuhës së shenjave në Republikën Shqipërisë"*. Në zbatim të VKM Nr.1074, datë 23.12.2015 *"Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara"* ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit është ngarkuar me detyrimin për hapjen e një programi shkollimi në shkollë të lartë (bachelor/master) për përgatitjen e interpretëve /përkthyesve të gjuhës së shenjave shqipe, si dhe të personelit shkencor në këtë fushë. Sipas Raport Monitorimit dhe Vlerësimit Afatmesëm të Planit Kombëtar të Veprimit Për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2018, publikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në mars 2019, rezulton se: *"Ka nisur puna për program të akredituar formimi profesional për instruktorët e gjuhës të shenjave. MSHMS, MASR, MFE dhe ANAD kanë hartuar marrëveshje të përbashkët ku parashikohen masa për realizimin e këtij aktiviteti që do të fillojnë së shpejti*." Sipas një studimi[11] të realizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është konstatuar se: *".Në lidhje me detyrimin për të zyrtarizuar dhe publikuar Fjalorin e Gjuhës së Shenjave Shqipe, MMSR[12] nuk ka marrë masa për ta zbatuar atë. Ky detyrim duhej të përmbushej brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit[13]."* Në drejtim të interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave shqipe, me shqetësim konstatohet një mungesë e tyre. Në kushtet kur ka mungesa të interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave shqipe, mungesa e mësuesve ndihmës të profilit "arsim special" që njohin gjuhën e shenjave shqipe është akoma më e madhe.

Fëmija ankueses, rezulton sipas vlerësimit të Komisionit Multidisiplinar se është një fëmijë që ka ndjekur kopshtin (grupin e tretë). Ky fakt tregon se ai është një fëmijë që ka qënë i identifikuar nga strukturat përgjegjëse vendore të arsimit parauniversitar ZVA Korçë-Pustec dhe DRAP Korçë. Gjithashtu procesi i identifikimit të fëmijëve që duhet të fillojnë klasën e parë, siç është fëmija D. F, është një proces që fillon kohë më parë se duhet të fillojë viti shkollor dhe përfshin një angazhim dhe koordinim të shumë institucioneve, bazuar në urdhrin e përbashkët nr. 292 datë 28.05.2019 *"Për miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor"*, e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar midis tri ministrive në vitin 2018. Sa më sipër tregon se mungesa e koordinimit dhe monitorimit të procesit nuk mund të

[11] Raport Monitorimi "Zbatimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara", faqe 31.
[12] Shkurtimi MMSR është përdorur për Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, sot Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila është përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar.
[13] I referohet VKM nr. 1074, datë 23.12.2015.

shërbejë si justifikim për mungesë fondesh, kur këto institucione kanë detyrimin që të sigurojnë arsim cilësor dhe të barabartë për të gjithë nxënësit në juridiksionin e tyre.

Gjithashtu ankuesja në datë 13.09.2019, i ka drejtuar një kërkesë DAR Korçë, për të siguruar një mësues ndihmës për djalin e saj, por nuk rezulton të ketë marrë asnjë përgjigje apo të jetë ndërmarrë nga ky institucion ndonjë veprim konkret në drejtim të sigurimit të një mësuesi ndihmës. Reagimi i parë i ZVA Korçë Pustec në lidhje me procedurat për të siguruar mësues ndihmës është pas kërkesës që shkolla 9 -vjeçare Stavri Themeli i ka drejtuar këtij institucioni.

Arsimi fillor i detyrueshëm, cilësor, falas dhe i arritshëm është një detyrim i menjëhershëm.[14] Ndërsa Pakti Për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore parashikon një realizim progresiv dhe pranon kufizimet për shkak të kufijve të burimeve të disponueshme, ai gjithashtu vendos detyrime të ndryshme të cilat kanë efekt të menjëhershëm. Një nga detyrimet me efekt të menjëhershëm për të garantuar të drejtën për arsim, është të garantojë që kjo e drejtë do të ushtrohet pa asnjë lloj diskriminimi.[15].

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Komentin e Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, në pikën 12, të tij shprehet se: "*Barazia dhe mosdiskriminimi janë parime dhe të drejta. Konventa u referohet atyre në nenin 3 si parime dhe në nenin 5 si të drejta. Ato janë gjithashtu një mjet interpretues për të gjitha parimet dhe të drejtat e tjera të mishëruara në Konventë. Parimet/e drejta për barazi dhe mosdiskriminim janë gur themeli i mbrojtjes ndërkombëtare të garantuar nga Konventa. Promovimi i barazisë dhe trajtimi i diskriminimit janë detyrime ndërsektoriale të realizimit të menjëhershëm. Ato nuk i nënshtrohen realizimit progresiv."*

Konventa e UNESCO Kundër Diskriminimit në Arsim, në nenin 1, pika 1, gërma "b", parashikon se: "*Për qëllimet e kësaj Konvente, termi "Diskriminimi" përfshin çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë për të cilën, duke u bazuar në raca, ngjyra, seksi, gjuha, bindjet fetare, politike apo të tjera, origjina kombëtare ose shoqërore, gjendja ekonomike ose lindja, ka si qëllim ose efekt e mohimin ose pengimin e barazisë në trajtim në arsim dhe në veçanti: ....."b"* ***duke kufizuar çdo person ose grup personash në një edukim të një standardi inferior****"*

Ndalimi i diskriminimit nuk i nënshtrohet as realizimit progresiv, as disponueshmërisë së burimeve; ai zbatohet plotësisht dhe menjëherë për të gjitha aspektet e arsimit dhe përfshin të gjitha shkaqet e mbrojtura të diskriminimit. Arsimi duhet të monitorohet nga afër - përfshirë të gjitha politikat, institucionet, programet, modelet e shpenzimeve dhe praktikat e tjera - në mënyrë që të identifikohen dhe të merren masa për të korrigjuar çdo diskriminim de-fakto[16].

[14] Shiko Komentin e Përgjithshëm nr. 4 (2016) mbi të drejtën për arsim përfshirës, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

[15] Shiko Komentin e Përgjithshëm Nr.13 (1999), të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, mbi të drejtën për arsim.

[16] Shiko Komentin e Përgjithshëm Nr.13 (1999), të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, mbi të drejtën për arsim.

Dështimi për t'u garantuar personave me aftësi të kufizuara akses të barabartë në shkollat e zakonshme me arsim përfshirës dhe cilësor, përbën diskriminim[17]. Sa më sipër rezulton se fëmijës së ankueses nuk i është garantuar arsim përfshirës cilësor pasi atij nuk i është garantuar mbështetja me mësues ndihmës sipas edhe parashikimeve ligjore në fuqi.

Shkelja e të drejtës për arsim mund të ndodh si nëpërmjet veprimeve ashtu edhe nëpërmjet mosveprimit duke mos marrë ato masa që autoritetet përgjegjëse janë të detyruara të ndërmarin për të siguruar të drejtën për arsim. Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7/1, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", garantohet për çdo veprim ose mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë. Pikat 1 dhe 2, të nenit 3, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi"*, përcaktojnë se diskriminimi i drejtpërdrejtë ndodh kur në një situatë të njëjtë ose të ngjashme, personi me aftësi të kufizuara trajtohet në mënyrë më pak të favorshme se personat e tjerë që nuk e kanë aftësinë e kufizuar. Motivi apo qëllimi për të diskriminuar nuk ka rëndësi në arritjen e konkluzionit nëse diskriminimi ka ndodhur apo jo, pasi në mungesë të qëllimit ekzistenca e pasojave tregon se diskriminimi ka ndodhur. Legjislacioni në fuqi në këtë drejtim nuk është diskriminues dhe ofron mbështetjen e mësuesit ndihmës, por autoritetet përgjegjëse kanë dështuar për të marrë masat për të adresuar diskriminimin de-fakto i cili në rastin konkret ka ardhur nga moszbatimi i duhur i tyre. Kjo përbën shkelje dhe cënim të të drejtës për të mos u diskriminuar.

Në bazë të nenit 25/2 të Ligjit "*Për istemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë dhe Zyra Vendore Arsimore Korçë-Pustec kanë si funksion sigurimin e zbatimit në praktikë të politikave dhe programeve në fushën e arsimit parauniversitar si sigurimin dhe mbikëqyrjen e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar. Në bazë të pikës 9, të VKM nr. 99 datë 27.02.2019 "*Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", DRAP Korçë dhe ZVA Korçë Pustec ngarkohen me përgjegjësinë për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar.

Në përfundim të analizës së mësipërme, Komisioneri vlerëson se fëmija i ankueses, është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme në raport me fëmijët e tjerë pa aftësi të kufizuara, pasi duke mos iu siguruar mbështetja me mësues ndihmës atij nuk i është siguruar një arsim gjithpërfshirës cilësor dhe në baza të barabarta. Ky trajtim i pafavorshëm është i lidhur pikërisht me faktin që fëmija D. F është një fëmijë me aftësi të kufizuara. Thënë kjo, nuk nënkupton që ka qënë qëllim i autoriteteve përgjegjëse për të bërë një trajtim të tillë, por se ata kanë dështuar për hequr pengesat dhe për të ofruar mbështetjen e parashikuar nga ligji. Vendosja në kushte më pak të favoshme ka si bazë aftësinë e kufizuar, pasi në mungesë të saj D. F nuk do të kishte nevojë për mbështetje. Komisioneri vlerëson se kjo vjen në

[17] Shiko Komentin e Përgjithshëm nr. 6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

kundërshtim me nenin 3/1/2, 7/1, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*" dhe se fëmija D. F, është diskriminuar në të drejtën e tij për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi",* Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në të drejtën për arsim të fëmijës D. F, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë dhe Zyrës Vendore Arsimore Korçë-Pustec.
2. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë dhe Zyra Vendore Arsimore Korçë-Pustec, të marrin masa të menjëhershme për sigurimin e mësuesit ndihmës për nxënësin D.F, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
3. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë dhe Zyra Vendore Arsimore Korçë-Pustec, të marrin masa që në një kohë sa më të shpejtë të sigurohet arsimimi i nxënësit D.F, në gjuhën e shenjave shqipe duke përfshirë edhe një mësues ndihmës që njeh gjuhën e shenjave shqipe.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë dhe Zyra Vendore Arsimore Korçë-Pustec, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
5. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

_____

Robert GAJDA

Fusha : Arsim
Shkaku: Aftësia e kufizuar